

BIZNESI SHQIPTAR ALBANIAN BUSINESS

QËNDRA PËR KËRKIM DHE ZHVILLIM TIRANË
CENTRE FOR RESEARCH AND DEVELOPMENT

Rr. "Luigj Gurakuqi",
P. 15/1, Shk. 1, Ap. 1
PO. Box 218/1 Tirana

Tel & Fax (0)4 230 445
Mobile: (0)69 22 40 906
E-mail: info@qkzh.org

Rezultatet e vërtetimit të
biznesit dhe konsumatorëve
Nr. 14, mars 2005

www.qkzh.org

Business and Consumer
Survey Results
No 14, March 2005


Në këtë numër:
Zhvillimet ne sektorin e industrisë
perpunuese



In this number:
Development in manufacturing sector

KLIMA E BIZNESIT/ BUSINESS CLIMATE

FIGURA 1: Treguesi i besueshmerise se QKZH ne industrine perpunuese - totali
CRD Confidence indicator in manufacture - total



Burimi: QKZH, Tirane, Rezultate te anketimit te biznesit

Klima e biznesit ne industri: ne rënie por mbetet pozitive

Business climate in manufacturing sector: is weakening but remains positive

Rezultatet e anketimit ne muajin Janar 2005 tregojne nje klime optimiste ne sektorin e industrisë perpunuese, megjithese ky optimizem eshte ne rënie per tre 3-mujore te njepasnjeshem.

Treguesi i besueshmerise¹ në muajin Janar 2005 shënon vlerën pozitive prej 6 pikësh, e cila është 1 pike me e ulët se 3 muaj me parë. Treguesi i besueshmerise ne muajin janar 2005 është 5 pike me e ulët se mesatarja e këtij treguesi per vitet 2002-04. Figura 1 tregon gjithashtu edhe per nje karakter sezonal te treguesit te besueshmerise per muajin janar duke shënuar rënie ne te gjitha periudhat e anketuara.

¹ Treguesi i besueshmerise ne industri llogaritet si mesatare arithmetike e nivelit te kontraktimeve, parashikimit te prodhimit dhe nivelit të gjëndjes së produkteve te gatshme (kjo e fundit me shenjë të kundërt)


Rënia e treguesit të besueshmërisë është influencuar kryesisht nga një pesimizem që vërehet për nivelin jo të kënaqshëm të kontraktimeve. **Treguesi i kontraktimeve** në muajin Janar shënon vlerën me të ulët historike për gjatë periudhës së anketimit prej 23 pikësh, i cili është 1 pikë më i ulët se 3 muaj më parë. Nga figura 2 shikohet se vleresimi i nivelit të kontraktimeve për muajin janar 2005 është 12 pikë më pak se një vit më parë dhe 13 pikë më e ulët se mesatarja 2 vjeçare (janar 02- tetor 04).

Një rënie e optimizmit tek menaxheret e firmave të intervistuar reflektohet edhe në **treguesin e parashikimit të punësimit**, ku ky tregues është në vlerën 0, e cila shënon nivelin më të ulët që nga fillimi i këtij anketimi në Janar të vitit 2002. Treguesi i balancës për parashikimin e punësimit (shiko figurën 3) është 11 pikë në përqindje më i ulët se 3 muaj më parë ndërsa në krahasim me mesataren e viteve 2002-2004 është 13 pikë në përqindje më pak.

Treguesi i kontraktimeve për eksport për janar 2005 shënon një balancë negative prej -5 pikësh por që në krahasim me 3 muaj më parë ka një ngritje me 25 pikë. Rënia e nivelit të kontraktimeve për eksport mund të ketë ardhur nga rënia e kërkesave për mallra eksporti. Vlera në përqindje për janar 2005 (shiko figurën 4) në krahasim me janar 2004 është 8 pikë më e lartë, madje kjo vlerë është më e lartë dhe se mesatarja 2002-2004, duke treguar një rritje të optimizmit të menaxherëve të firmave në lidhje me nivelin e kontraktave për eksport.


Treguesi i ecurisë së prodhimit në 3 muajt e kaluar është pozitiv me 9 pikë dhe shënon një vlerë prej 4 pikësh në përqindje më të madhe se vlera e tetorit 2004. Figura 5 tregon gjithashtu se balanca në përqindje prej 9 pikësh e janar 2005 është më e ulët se mesatarja 2-vjeçare (janar 02- tetor 04) por është më e lartë se vlera për të njëjten periudhë e janar 2004 me 6 pikë gjithsej. Pas muajit prill 2004 shënohet dhe vlera më e ulët e vleresimit të aktivitetit të prodhimit në industrinë perpunuese me -14 pikë duket se kemi një stabilitet në vlera pozitive për tre 3-mujoret e fundit.

FIGURA 2: Vleresimi i nivelit të kontraktimeve në industrinë perpunuese - totali
Assesment of order-books in manufacturing - total




Burimi: QKZH, Tirane, Rezultate të anketimit të biznesit

FIGURA 3: Parashikimi i punësimit në industrinë perpunuese 2002-2005
Employment expectations in manufacturing sector total 2002-2005




Burimi: QKZH, Tirane, Rezultate të anketimit të biznesit

FIGURA 4: Vleresimi i kontratave për eksport në sektorin e industrisë perpunuese
Assesment of export order-books in manufacture - total




Burimi: QKZH, Tirane, Rezultate të anketimit të biznesit

FIGURA 5: Vleresimi i aktivitetit të prodhimit në industrinë perpunuese në 3 muajt e kaluar - totali
Assesment of production activity in manufacture the last 3 months - total




Burimi: QKZH, Tirane, Rezultate të anketimit të biznesit

FIGURA 6 : Shfrytezimi i kapaciteteve prodhuese ne industrine perpunuese - totali
Capacity utilisation in manufacture - total



Burimi: QKZH, Tirane, Rezultate te anketimit te biznesit

FIGURA 7: Parashikimi i aktivitetit te biznesit ne industrine perpunuese - totali
Expectation of business activity in manufacture - total




Burimi: QKZH, Tirane, Rezultate te anketimit te biznesit

FIGURA 8: Vleresimi i çmimeve te shitjes ne industrine perpunuese - totali



Burimi: QKZH, Tirane, Rezultate te anketimit te biznesit

FIGURA 9 : Vleresimi i produkteve te gatshme ne industrine perpunuese - total



Burimi: QKZH, Tirane, Rezultate te anketimit te biznesit

Ne figuren 6 eshte paraqitur **shfrytezimi i kapaciteteve prodhuese** ne industrine perpunuese per periudhen e anketimit janar 2002 - janar 2005. Ecuria e aktivitetit te prodhimit percakton ne nje fare menyre dhe shkallen e e shfrytezimit te kapaciteteve prodhuese. Ne janar 2005 shfrytezimi i kapaciteteve prodhuese kap nivelin e 56.6 % duke shenuar rritje ndaj tetor 2004 dhe duke ju perafuar vleres se muajit korrik 2004 me nje diference prej nje pike. Kete tre mujor kemi nje shfrytezim me rreth 5.3 % me shume se ne krahasim me 3 mujorin e fundit te 2004.

Po keshtu shikohet edhe nje renie e optimizmit ne **parashikimin e prodhimit ne 3 muajt e ardhshem**, ku balanca e pergjigjeve te biznesmeneve te pyetur eshte pozitive prej 14 pikesh nga 23 perqind qe ishte ky tregues 3 muaj me pare. Vlera e janar 2005 prej 14 pikesh (figura 7) eshte e perafert me vleren e se njetes periudhe nje vit me pare pra janar 2004 por eshte gati me 9 pike ne perqindje me e vogel se mesatarja e dy vjecare.

Balanca e pergjigjeve ne lidhje me **vleresimin e cmimeve te prodhimit** tregon per nje renie prej 27 pikesh ne krahasim me 3 muaj me pare, duke zbritur ne vlerat negative prej 15 pike, e cila mund te jete pasoje e renies se kerkeses per prodhimet industriale te firmave te intervistuar, qe mund te shoqerohet me nje renie te cmimeve. Renia e cmimeve te shitjes ne industrine perpunuese ne janar 2005 shenon dhe vleren me te ulet te ketij treguesi gjate gjithe periudhes se vleresimit, si dhe ndaj mesatares dy vjecare qe ka vlere pozitive.

Figura 9 paraqet **vleresimin e gjendjes se produkteve te gatshme** ne sektorin e industrise perpunuese. Sic mund te vihet re ne anketimin e biznesit ne muajin janar 2005 vazhdojne te ruhen vlera negative te ketij treguesi. Firmat prodhuese te intervistuar ende nuk ndihen te sigurta ne tregun e shitjes gje qe e tregon dhe vlera negative prej 26 pikesh ne janar 2005. Vitin e fundit ky tregues ka shenuar vlera negative duke treguar renien e optimizmit tek menaxheret e firmave.

Pengesat ne sektorin e industrise perpunuese *Constrains within manufacturing sector*

Anketa e biznesit e muajit janar 2005 ne baze te pergjigjeve te drejtuesve te firmave ne sektorin e industrise perpunuese evidenton si pengesen kryesore, mungesen e energjise elektrike.

Mungesa e energjisë elektrike permendet si pengese nga 60 perqind e firmave te anketuara. Ky nivel eshte 4 perqind me i larte se 3 muaj me pare, por eshte me i ulet nga nje vit me pare me 12 pike dhe nga niveli mesatar me afersisht 10 pike me pak (shiko figuren 10).


Keq-hartimi apo keq-zbatimi i legjislacionit fiskal permendet nga 57 perqind e te anketuarve. Nga figura 11 shikohet se ky nivel ne perqindje eshte 22 pike me i larte se nje vit me pare, por 4 perqind me i ulet se 3 muaj me pare.

Ndikimi i **mungesës së infrastrukturës** gjithashtu eshte faktor me ndikim pengues në rritje (shiko figuran 12), pasi në muajin janar ai përmendet nga 56 perqind e të intervistuarve, nga 45 perqind që përmendej 3 muaj më parë. Gjithashtu ky tregues eshte me afersisht 20 pike me i larte se mesatarja 2002-2004.

Nje faktor qe ndikon negativisht ne situaten e biznesit duket se po behet edhe **paqendrueshmeria makroekonomike**, ku ndikimin me te madh me sa duket e ka ndikimi i rivleresimit te forte te lekut. Faktorë pengues me ndikim në rritje janë shënuar edhe faktore te tjere si **mungesa e fuqise punetore te kualifikuar, mungesa e kërkesës nga jashtë, mungesa e paisjeve të përshtshme.**

FIGURA 10: **Ndikimi i mungesave te energjise elektrike ne sektorin e industrise**


The impact of shortages on electricity in manufacture - total



Burimi: QKZH, Tirane, Rezultate te anketimit te biznesit

FIGURA 11: **Ndikimi i legjislacionit fiskal ne sektorin e industrise - totali**


The impact of fiskal legislation in manufacture - total



Burimi: QKZH, Tirane, Rezultate te anketimit te biznesit

FIGURA 12: **Ndikimi i mungeses se infrastrukturës ne sektorin e industrise**

The impact of lack of infrastructure in manufacture - total



Burimi: QKZH, Tirane, Rezultate te anketimit te biznesit